




Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 588/2024

Datë: 28 maj 2024

Këshilli Prokurorial i Kosovës, duke vendosur në çështjen disiplinore ndaj znj. Elfete Purova, Prokurore në Prokurorinë Themelore në Prizren, në pajtim me nenin 7 paragrafi 1 pika 11 dhe nenit 34 të Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, sipas Raportit të Panelit Hetimor në rastin AD.nr. 08/2023 të datës 16 Maj 2024, gjatë shqyrtimit të mbajtur me datë 28 Maj 2024, në seancën e këshillimit e votimit mori këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet Pjesërisht** Raporti i panelit hetimor AD.nr. 08/2023 të datës 16 Maj 2024, në rastin disiplinor të prokurores Elfete Purova, Prokuroria Themelore në Prizren;
- II. **Vërtetohet** se, prokurorja Elfete Purova ka vepruar në kundërshtim me nenin 6 paragrafi 2 nën paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 dhe paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve;
- III. Prokurores Elfete Purova i shqiptohet sanksioni disiplinor, **“Vërejtje Publike me Shkrim”**, sipas nenit 7 paragrafi 1 pika 1.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

A r s y e t i m

Me datë 07 Dhjetor 2023, Kryeprokurori në cilësinë e Autoritetit Kompetent në Prizren, z. Admir Shala, pas pranimit të informatës nga ana e prokurorëve të cilët kanë qenë në përfaqësim të lëndës [REDACTED] të Gjykatën Themelore Prizren-Dega Suharekë, të cilët kanë vërejtur se aktakuza ka qenë e ngritur jashtë afatit ligjor, ka paraqitur kërkesë

AD.nr.08/2023, për fillimin e hetimeve ndaj znj. Elfete Purova, prokurore në Prokurorinë Themelore në Prizren.

Sipas Autoritetit Kompetent, pretendohet se prokurorja Elfete Purova ka vepruar në shkelje të nenit 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 dhe pika 2 nën paragrafi 2.1 të Ligjit për Përgjegjësi Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, sepse e njëjta ka ngritur aktakuzën me numër [REDAKTUAR] jashtë afatit ligjor, duke marrë parasysh faktin se afati ka qenë 2 vite, e në rastin konkret kanë kaluar 2 vite e 4 muaj. Bazuar në nenin 159 të KPP-së "Kur fillohet hetimi, hetimi përfundon brenda dy viteve. Nëse brenda dy viteve nga fillimi i hetimeve nuk është ngritur aktakuza, ose nuk është pezulluar hetimi" sipas nenin 157, të këtij Kodi, hetimi menjëherë pushohet.

Në rastin konkret sipas Autoritetit Kompetent, subjekti i hetimit, prokurorja Purova nuk ka ndërmarr veprimet prokuroriale që kërkohen me ligj.

Këshilli Prokurorial i Kosovës, me vendimin me numër KPK/nr.1031/2023 të datës 22 dhjetor 2023, ka themeluar Panelin Hetimor për hetimin e rastit disiplinor AD.nr.08/2023, ndaj znj. Elfete Purova, Prokurore në Prokurorinë Themelore në Prizren.

Paneli Hetimor pas hetimit të rastit, në bazë të nenit 13 të Ligjit me nr.06/L-057 për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe Nenit 14 (7), (8) të Rregullores nr. 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve ka arritur marrëveshje vullnetare për zgjidhjen e kësaj çështje disiplinore. Nga të gjeturat Paneli Hetimor ka vërtetuar se, Prokurorja Elfete Purova ka vepruar në shkelje të nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 të Ligjit për Përgjegjësi Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve sepse e njëjta ka ngritur aktakuzë jashtë afatit ligjor, që sipas panelit hetimor në rastin konkret me veprimet e subjektit të hetimit janë shkelur detyrat e saj zyrtare si prokuror i shtetit.

Palët në negociim të marrëveshjes për pranimin vullnetar të fajësisë janë pajtuar që Këshillit Prokurorial të Kosovës t'i rekomandojnë sanksionin disiplinor "Vërejtje Jo Publike me shkrim", komfor nenit 7 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.1 të Ligjit nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë.

Këshilli Prokurorial i Kosovës duke vendosur në çështjen disiplinore ndaj Elfete Purova, Prokurore në Prokurorinë Themelore në Prizren, në pajtim me nenin 34 të Ligjit Nr. 06/L - 056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 13 të Ligjit Nr. 06/L - 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, sipas Marrëveshjes vullnetare për shkeljen e supozuar disiplinore AD.nr.08/20223, të datës 05 Mars 2024, gjatë shqyrtimit të mbajtur më datë 19 Mars 2024, në seancën e këshillimit dhe votimit me shumicë votash ka refuzuar marrëveshjen vullnetare duke i'a kthyer rastin Panelit Hetimor për të vërtetuar gjendjen e plotë faktike të shkeljes disiplinore.

Këshilli Prokurorial i Kosovës ka gjetur se, marrëveshja vullnetare nuk është në pajtim me nenin 13 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtar dhe Prokuror për shkak se nuk janë kryer veprimet e nevojshme hetimore.

Me datë 16 Maj 2024, Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) ka pranuar nga Paneli Hetimor, Raportin AD.nr. 08/2023 me të cilin, Paneli Hetimor i KPK-së ka ardhur në përfundim se prokurorja Elfete Purova, ka vepruar në shkelje të nenit 6 paragrafi 1 pika 1.3 dhe paragrafi 2 pika 2.1 të Ligjit Nr.06/L-057, për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve sepse, i njëjta ka shkelur detyrat e saj zyrtare si prokurorë dhe nuk ka ndërmarrë veprime prokuroriale, që kërkohet me ligj, me ç' rast ka ngritur aktakuzën jashtë afatit ligjor dhe atë pas 2 viteve e 4 muaj, nga fillimi i hetimeve penale.

Këshilli Prokurorial i Kosovës në mbledhjen e mbajtur me datë 28 Maj 2024, pasi që ka shqyrtuar raportin e dorëzuar nga Paneli Hetimor, ka dëgjuar Raportimin e Kryesuesit të Panelit Hetimor i cili ka elaboruar të gjitha faktet dhe provat e mbledhura gjatë procedurës hetimore. Në seancën disiplinore ka prezantuar edhe subjekti i hetimit disiplinor, prokurorja Elfete Purova, e cila në mbrojtjen e saj nuk e ka mohuar faktin se i ka ikur afati mirëpo duke u arsyetuar se, ka ndodhur nga pakujdesia dhe ka shprehur keqardhje për këtë.

Këshilli Prokurorial i Kosovës pas dëgjimit të Kryesuesit të Panelit Hetimor, Subjektit të Hetimit si dhe shqyrtimit, analizimit, krahasimit të provave të cekura në raportin e panelit hetimor, fjalës përfundimtare të Kryesuesit të Panelit Hetimor dhe subjektit të hetimit, erdhi në përfundim se, në rastin konkret, rasti penal [REDACTED] është përcjellë me lëshime serioze nga prokurorja Elfete Purova. Neglizhenca në trajtimin e rastit nga subjekti i hetimit është vërtetuar nga pranimi i lëndës në punë, sepse është dashur të sigurohet për afatet lidhur me ndërmarrjen e veprimeve. Prokurorja Purova ka dështuar në ushtrimin e funksionit prokurorial sepse, lëshimet e ndodhura edhe pse nga pakujdesia kanë qenë të dëmshme për të tjerët, andaj mosveprimi në kohë si në rastin konkret nuk mund të përjashton përgjegjësinë disiplinore.

Sipas Këshillit Prokurorial i Kosovës, për rastin e vërtetuar me shkelje disiplinore nga pakujdesia e rëndë, sanksioni disiplinor **"Vërejtje Jo Publike me Shkrim"** i propozuar sipas Autoriteti Kompetent dhe Raportit të Panelit Hetimor, nuk është në nivel të proporcionalitetit në mes të shkeljes disiplinore dhe masës disiplinore.

Andaj, për rastin e vërtetuar me shkelje serioze, sanksioni disiplinor **"Vërejtje Publike me Shkrim"** është në përputhje me shkeljet e gjetura si në raportin e panelit hetimor. Sanksioni disiplinor si në nenin tre të dispozitivit të këtij vendimi, do të ketë efekt pozitiv mbi vet prokuroren Elfete Purova, që në të ardhmen të veproj konform dispozitave ligjore.

Nga sa u tha më lart, Këshilli Prokurorial i Kosovës në bazë të vlerësimit të çështjes mori vendim si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese brenda 15 ditëve, pas pranimi të vendimit drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Ardian Hajdaraj

Kryesues i Këshillit Prokurorial i Kosovës

T'u dërgohet:

- z. Admir Shala Kryeprokuror në Prokurorinë Themelore në Prizren
- znj. Elfete Purova, prokurore në Prokurorinë Themelore në Prizren
- Arkivit të KPK-së